



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2008 – 2015**







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2008 – 2015**



Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Qershor, 2016

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së  
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), respektivisht Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare ka përgatitur publikimin e Llogarive Qeveritare të Kosovës 2008 – 2015. Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

ASK-ja i është mirënjohës Ministrisë së Financave – Departamenti i Thesarit, Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) për ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim.

Komentet, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në adresën elektronike: [economic@rks-gov.net](mailto:economic@rks-gov.net).

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha – Drejtor i departamentit,  
Xhevrie Fetahu – Shefe e divizionit,  
Ilir Mazrekaj – zyrtar i lartë,  
Ylli Shala – zyrtar i lartë.

Qershor, 2016

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së  
Z. Isa Krasniqi

## Lista e Shkurtesave

BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
ESA	-	Llogaritë e Sistemit Evropian (European System of Accounts)
ASK	-	Agjencia e statistikave të Kosovës
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MF	-	Ministria e Financave
TKPK	-	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
:	-	Mungojnë të dhënat
—	-	Nuk aplikohet

## Përmbajtja

	Faqe
1 Hyrje .....	4
2 Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme .....	5
Grafiku 1: Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme 2015 .....	5
Tabela 1: Struktura e të Hyrave të Qeverisë së Përgjithshme .....	6
3 Shpenzimet – Qeveria e Përgjithshme.....	7
Grafiku 2: Shpenzimet - Qeveria e Përgjithshme 2015.....	7
Tabela 2. Struktura e Shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme .....	7
Grafiku 3: Shpenzimet Qeveritare në bazë të sektorëve .....	8
Tabela 3: Shpenzimet Qeveritare në bazë të sektorëve.....	8
4 Sistemi i fondit pensional.....	9
Tabela 4: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës .....	10

## **1. Hyrje**

Publikimi paraqet një pasqyrë të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 2008 – 2015, bazuar në mbledhjen e të dhënave administrative dhe kalkulimeve të ASK-së.

Si rregull i përgjithshëm ka për qëllim pajtueshmërinë maksimale të shifrave të publikuara me standardet e ESA 2010 dhe manualin e FMN-së për statistikat e Financave Qeveritare.

Burimet e të dhënave janë: Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit dhe Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës .



## 2. Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme


Shuma e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme në vitin 2015 ishte 1,706.1 milion Euro.

Në krahasim me vitin e kaluar kemi një rritje prej 26.4 % të të hyrave.

Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte të cilat paraqesin 65% të totalit të të hyrave , ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave.

Struktura e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 1:

**Grafiku 1: Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme 2015**



Pjesa më e madhe e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është si rezultat i importit të njësive ekonomike në Kosovë, që e përbëjnë tatimet e mbledhura në kufi. Struktura e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Tabelën 1, prej të cilave:

- Të Hyrat Kufitare paraqesin: tatimin në vlerën e shtuar në kufi, akciza e jashtme në kufi, akciza e brendshme, detyrime doganore te importit, taksa te ndryshme doganore si dhe taksa doganore te paspecifikuara,
- Te Hyrat e brendshme paraqesin: tatimin në vlerën e shtuar – vendore, tatimi në të ardhura personale, tatimi ne korporata, tatimi në fitim, tatimi i paragjykuar dhe të hyrat tjera nga Administrata Tatimore të paspecifikuara.
- Të Hyrat nga interesi dhe shitja përfshijnë pranimet në nivelin Qendror dhe Lokal, të cilat nuk mbliidhen nga Administrata Tatimore, por që administrohen nga organizatat tjera buxhetore Qendrore dhe Lokale.

**Tabela 1: Struktura e të Hyrave të Qeverisë së Përgjithshme**

Përshkrimi	në milion Euro							
	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Tatimi mbi vleren e shtuar -TVSH	363.4	403.1	455.7	540.2	547.8	558.7	558.8	610.1
Tatimi dhe dogana ne import duke perjashtuar TVSH	(0.1)	(0.1)	(0.1)	(0.0)	(0.3)	(0.6)	(0.4)	-
Dogana	93.1	98.0	103.9	121.0	117.2	119.1	125.6	130.7
Tatimet ne importe duke perjashtuar TVSH dhe Doganen	132.4	150.4	157.6	200.0	303.0	300.8	315.3	355.8
Tatimi ne Produkte, perjashtuar TVSH dhe tatimet e importit	74.4	60.0	78.4	88.7	5.9	0.1	0.1	0.7
<b>Tatimi ne Produkte</b>	<b>663.2</b>	<b>711.5</b>	<b>795.5</b>	<b>949.8</b>	<b>973.6</b>	<b>978.1</b>	<b>999.4</b>	<b>1,097.3</b>
Tatimet tjera ne Prodhim	18.1	15.4	30.3	40.7	25.0	37.4	37.2	30.4
Te hyrat nga Prona	1.8	2.9	1.6	1.4	1.7	1.6	12.2	6.6
Interesi *	8.8	5.4	11.7	1.6	0.0	(0.0)	0.0	168.0
Te hyrat nga Korporata	8.6	0.0	0.0	0.1	0.0	0.6	0.2	0.1
Dividentat	-	200.0	83.2	61.5	44.1	31.8	8.8	14.7
Te hyrat nga tatimet	161.5	127.9	123.3	134.4	149.9	155.4	155.1	176.3
Tatimet tjera aktuale	41.2	40.9	42.7	53.6	69.7	72.4	73.1	55.8
Net primet e sigurimit jo jetesor	0.0	0.2	0.1	0.4	0.1	0.1	0.1	0.0
Transfertat aktuale brenda qeverisë së përgjithshme	5.1	-	(0.1)	(0.6)	(0.0)	(0.1)	(0.0)	(0.4)
Bashkepunimi me Organizatat nderkombetare	17.6	-	16.7	31.4	55.2	25.1	20.6	76.2
Transferet tjera te ndryshme	8.0	8.3	9.4	10.0	7.8	7.5	14.8	12.4
Te ardhurat Kapitale	1.5	1.3	1.4	1.6	1.6	1.6	1.6	-
Transferet tjera kapitale	0.6	-	-	0.4	0.9	0.2	0.3	1.1
Shitjet	45.4	53.4	50.1	52.0	55.6	51.7	56.9	67.5
Posedimi I të gjitha asetëve	-	-	-	-	29.1	26.3	-	-
Rimbursimet nga tatimet	(21.3)	(24.8)	(27.0)	(27.1)	(31.0)	(34.0)	(30.7)	-
Te tjera	(0.2)	0.01	-	0.03	0.01	0.01	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>959.9</b>	<b>1,142.4</b>	<b>1,139.0</b>	<b>1,311.3</b>	<b>1,383.4</b>	<b>1,355.7</b>	<b>1,349.5</b>	<b>1,706.1</b>

\* 2015 perfshi letrat me vlere , kredit etj


### 3. Shpenzimet – Qeveria e Përgjithshme

Në vitin 2015 totali i shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme ishte 1,612.3 milion Euro.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë pagat dhe medijtjet me pjesëmarrje 31%, formimi i bruto kapitalit fiks me pjesëmarrje 24% ,kontributet sociale dhe përfitimet, me pjesëmarrje 19%, konsumi i ndërmjetëm, me pjesëmarrje prej 14%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndar në struktura tjera të shpenzimeve.

Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 2:

**Grafiku 2: Shpenzimet - Qeveria e Përgjithshme 2015**



**Tabela 2. Struktura e Shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme**


*(në milion Euro)*

Përshkrimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Pagat dhe Medijtjet	235.3	268.8	307.1	372.7	394.3	427.8	489.52	504.13
Kontributet pensionale te punëtorëve	10.8	12.7	30.0	36.9	38.9	19.9	23.14	24.95
<b>VLERA E SHTUAR</b>	<b>246.1</b>	<b>281.6</b>	<b>337.1</b>	<b>409.5</b>	<b>433.2</b>	<b>447.7</b>	<b>512.7</b>	<b>529.1</b>
Konsumi i ndërmjetëm	144.0	151.9	163.7	160.9	172.7	187.6	187.23	216.23
<b>OUTPUT</b>	<b>390.1</b>	<b>433.5</b>	<b>500.7</b>	<b>570.5</b>	<b>605.9</b>	<b>635.3</b>	<b>699.9</b>	<b>745.3</b>
Kontributet sociale dhe përfitimet	137.9	156.1	171.8	176.3	198.5	228.7	282.06	306.93
Tatimet Kapitale	20.1	13.5	17.3	14.1	13.9	11.9	9.40	12.49
Formimi i Bruto Kapitalit Fiks	337.4	390.3	448.5	521.6	544.8	527.5	403.45	387.51
Subvencionet	72.1	100.8	81.6	80.2	81.8	87.0	82.46	115.17
Interesi	-	43.8	-	-	-	-	34.88	44.88
<b>Gjithsej</b>	<b>957.6</b>	<b>1,138.0</b>	<b>1,220.0</b>	<b>1,362.7</b>	<b>1,445.0</b>	<b>1,490.2</b>	<b>1,512.1</b>	<b>1,612.3</b>

### Grafiku 3: Shpenzimet Qeveritare në bazë të sektorëve

Në vitin 2015 shuma e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme ishte 1,612.3 milion Euro. Shpërndarja më e madhe e shpenzimeve është bërë në shërbime të përgjithshme me pjesëmarrje prej 23%, pjesa tjetër në mbrojtje sociale me pjesëmarrje prej 19%, çështjet ekonomike me pjesëmarrje prej 20%, arsimit me pjesëmarrje prej 16%; ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në sektorët e tjerë.

Shpërndarja në përqindje e shpenzimeve sipas sektorëve është paraqitur në grafikun 3.



### Tabela 3: Shpenzimet Qeveritare në bazë të sektorëve

Shuma e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme në vitin 2015 ishte 1,612.3 milion Euro, në krahasim nga viti i kaluar kemi një rritje prej 6.6 % të shpenzimeve.

(në milion Euro)

Përshkrimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shërbimet e përgjithshme	192.3	283.8	276.1	271.5	277.6	324.1	463.3	369.3
Mbrojtja	18.5	21.2	26.5	29.6	31.3	30.5	28.1	34.8
Rendi dhe siguria publike	80.6	90.6	101.7	104.5	117.1	116.1	102.2	84.6
Çështjet Ekonomike	277.1	292.1	332.6	422.1	431.4	388.5	254.6	322.8
Mbrojtja e Mjedisit	2.1	2.5	3.1	1.8	2.0	3.0	6.7	13.9
Strehim dhe pajisje për Komunitetin	20.2	28.5	31.8	26.2	30.5	36.6	36.7	28.6
Shëndetësia	81.3	99.6	108.6	119.1	128.6	138.7	114.3	164.8
Rekreacioni, kultura dhe Religjioni	12.5	14.7	16.0	20.1	30.5	30.5	31.3	33.3
Arsimi	130.9	145.5	162.6	194.3	198.2	204.4	207.3	261.9
Mbrojtja sociale	142.2	159.6	161.0	173.5	197.9	217.9	267.7	298.3
<b>Gjithsej</b>	<b>958</b>	<b>1,138.0</b>	<b>1,220.0</b>	<b>1,362.7</b>	<b>1,445.0</b>	<b>1,490.2</b>	<b>1,512.1</b>	<b>1,612.3</b>

## 4. Sistemi i fondit pensional

Sistemi i sigurimit social është disi më i komplikuar. Sistemi pensional është i përbërë nga 3 shtylla, secila prej tyre dallon në mënyrën se si financohen dhe në shtresën e popullatës të cilën e mbulojnë:

Shtylla e parë - është skema e asistencës themelore sociale, e cila është e zbatueshme jo vetëm për të moshuarit. Kjo është e integruar në Qeverinë Qendrore, që do të thotë se është pjesë përbërëse e Qeverisë. Pagesat pensionale nën këtë konsiderohen si dobi sociale të përfshira në shpenzimet të Transferet rrjedhëse të Ekonomive Shtëpiake. Kjo është e financuar nga faturat e Qeverisë së Përgjithshme.

Shtylla e dytë - është skema e kursimeve të detyrueshme pensionale. Kjo skemë ka filluar së funksionari në gusht të vitit 2002, kur punëdhënësit e mëdhenj dhe agjencitë shtetërore kanë qene të obliguar për kontribute. Prej vitit 2003 skema e kursimeve të obligueshme është zgjeruar për të përfshirë të gjithë punonjësit e Kosovës e të vetpunësuarit. Kursimet e detyrueshme pensionale administrohen dhe menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). TKPK pranon kontribute pensionale në vlerë prej 10% të pagës bruto të ndara në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve (5%+5%), ndërsa për të vetpunësuarit 10 % të të ardhurave të fituara. TKPK i investon këto mjete përmes menaxhuesve të specializuar të mjeteve.

Shtylla III - Nenet e Rregullores mbi Pensionet mbi skemat vullnetare sigurojnë që këto skema të jenë të sigurta, të financuara në mënyrë adekuate dhe transparente. Skemat e pensioneve vullnetare paraqesin opsion për biznese e institucione të ndryshme financiare dhe mund të financohen nga kontributet e punëdhënësve dhe/ose të të punësuarve. Departamenti i Pensioneve në [BQK](#) liçencon dhe monitoron skemat vullnetare.

Vlen të theksohet që sistemi kryesor pensional, i cili tani është në formë embrionale, do të jetë shumë më i rëndësishëm në vitet që në vijim. Kjo pjesë është regjistruar jashtë Qeverisë. Kontributet e pagesave të pensioneve janë rrjedha në mes të Ekonomive shtëpiake dhe sektorit të korporatave financiare.

Nga këndvështrimi ekonomik nuk duket të jetë plotësisht e kënaqshme që sistemi kryesor pensional i detyrueshëm nuk është reflektuar në llogarinë e Qeverisë. Kështu që publikimet e ASK-së për Llogaritë Qeveritare, në parim përmbajnë një pasqyrë, pro memoria, të situatës së shtyllës së financuar(kontributet, të hyrat e aseteve, pagesat dhe asetet).

**Tabela 4: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës***(në milion Euro)*

Vitet	Kontributet e mbledhura pensionale	Kthimet e investimeve	Provizionet, kthimet dhe pagesat tjera	Saldo e aseteve pensionale
2004	44	1	1	83
2005	52	11	2	144
2006	57	16	28	188
2007	64	6	5	252
2008	73	-91	6	228
2009	83	47	7	350
2010	95	26	8	463
2011	108	3	12	563
2012	113	54	16	715
2013	119	71	17	888
2014	129	67	21	1,063
2015	138	30	24	1,206

*Burimi: Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës*

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

657(496.51) “2008/2015”(084.2)

Llogaritë qeveritare : (2008-2015) / [Publikimin përgatitën Ilir T. Berisha...et al.]. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016. - 9 f. : ilustr. ; 28 cm. - (Serija ; 3 : Statistikat Ekonomike )

Parathënie / Isa Krasniqi: f. [II]

1.Berisha, Ilir T.

**ISBN 978-9951-22-269-3**

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-269-3

